



BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

**ILD PËRFUNDON TRAJTIMIN E STOKUT TË ANKESAVE TË
TRASHËGUARA NGA INSTITUCIONE TË TJERA**





ILD PËRFUNDON TRAJTIMIN E STOKUT TË ANKESAVE TË TRASHËGUARA NGA INSTITUCIONE TË TJERA

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka arritur të përfundojë trajtimin e stokut prej 2104 ankesash e praktikash dokumentare të trashëguara, krahas punës së përditshme që inspektorët kanë me trajtimin e ankesave të depozituara direkt në ILD, procedimeve disiplinore, si dhe inspektimeve tematike e institucionale.

Ky fond i konsiderueshëm përmbante ankesa të patrajtuara, ankesa të trajtuara pjesërisht, apo në faza fillestare të shqyrtimit të tyre, si dhe raste të hetuara pjesërisht, apo të papërfunduara nga ana e organeve të mëparshme, institucione që kanë qenë përgjegjëse për trajtimin e ankesave ndaj

magjistratëve, apo që kanë vepruar gjatë periudhës kalimtare 2017-2020, deri në ngritjen e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Nga trajtimi i stokut ka rezultuar se procedurat e paplota të ndjekura nga organet e mëparshme për trajtimin e këtyre ankesave praktikave dokumentare, për shkak të kompetencave të kufizuara e të ndara ndërmjet organeve të ndryshme gjatë periudhës kalimtare, janë trajtuar plotësisht nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ecuria tre vjeçare e trajtimit të këtij stoku të trashëguar ankesash reflekton rritjen e numrit të inspektorëve magjistratë e jomagjistratë vit

pas viti pranë ILD-së, duke rritur volumin e trajtimit të stokut, respektivisht 72 ankesa të trajtuara në vitin 2020, 427 në vitin 2021, 534 në vitin 2022 dhe 1047 në vitin 2023.

Një metodologji e posaçme, e miratuar dhe publikuar në faqen zyrtare të institucionit, është përdorur për trajtimin e stokut, sipas një radhe përparësie të bazuar në kritere si: data e dorëzimit, faza e trajtimit nga ana e organeve të mëparshme, tipologjia ose urgjenca e trajtimit të ankesës, respektimi i parimit të barazisë dhe objektivitetit, si dhe koha e nevojshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e secilës praktikë dokumentare.

Nga stoku i trashëguar prej 2104 ankesash janë arkivuar 2080 ankesa, 14 ankesa janë në proces verifikimi dhe 10 ankesa janë në proces hetimi disiplinor.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar 34 vendime për vazhdim hetimi disiplinor, me anë të të cilave janë hetuar shkeljet e pretenduara ndaj veprimtarisë së 58 magjistratëve. (58 gjyqtarë). Nga këto 34 hetime disiplinore, 9 prej tyre kanë përfunduar me kërkesë për procedim disiplinor, që të 9 magjistratë gjyqtarë.

Masat disiplinore të propozuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ishin “Shkarkim nga detyra”, për 3 gjyqtarë; “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40% për një periudhë jo më të gjatë se një vit” për 5 gjyqtarë dhe për 1 gjyqtar u propozua masa disiplinore “Vërejtje publike”.

Për këto kërkesa të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka pranuar pjesërisht kërkesën për shkarkim nga detyra për 1 gjyqtar, duke vendosur për të një masë të ndryshme disiplinore, ndërsa në 2 rastet e tjera janë mbyllur pa vendim. Për 5 rastet, kur është

kërkuar ulje page, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pranuar 2 pjesërisht, ndërsa 3 raste i ka pezulluar për shkak të procesit të rivlerësimit. Për një gjyqtar për të cilin ishte kërkuar masa “Vërejtje publike”, KLGJ ka vendosur pezullim për shkak të procesit të rivlerësimit.

Me trajtimin e këtij fondi të trashëguar nga institucione të tjera, nëpërmjet procedimit disiplinor të magjistratëve për çështje apo ankesa të sjella në organet inspektuese shumë vite më parë, ILD ka plotësuar jo vetëm detyrimin ligjor, por përcjell edhe një mesazh të rëndësishëm për këdo mbi kulturën e pاندëshkueshmërisë dhe të mosharresës.





MBROJTJA MË E MIRË E PUNËS SË INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË ËSHTË TRANSPARENCA

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani po zhvillon një vizitë pune në SHBA, me ftesë të Open Gov Hub USA, së bashku me kolegë nga institucione të tjera të drejtësisë të Shqipërisë.

Gjatë vizitës, mikpritësit organizuan eventin publik me temë “Reforma në drejtësi në Shqipëri.

Konstitucionalizmi në veprim”, mbi të cilën ndahen mendimet e tyre, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani, kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami dhe kryetari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, z. Roland Ilia, të cilët më pas iu përgjigjën pyetjeve të audiencës.



Duke folur për gjetjen e ekuilibrit të duhur, midis një qeverisjeje të qëndrueshme, solide dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, z. Metani bëri krahasimin me mënyrën e punës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

“Nga pikëpamja kushtetuese, përcaktimi i kufijve se kur duhet të hetojmë punën e një gjyqtari/prokurori, nuk është diçka e thjeshtë, nuk është diçka e shkruar qartë, pasi siç thashë ka disa kufij virtualë, të cilët ne duhet t’i shohim, jo vetëm t’i shohim por edhe t’i respektojmë, dhe jo vetëm t’i respektojmë, por gjithashtu t’ua shpjegojmë njerëzve dhe shoqërisë.

Prandaj mendoj se puna e institucioneve të drejtësisë me organizatat e shoqërisë civile është tejet e rëndësishme, për të ndihmuar njëri-tjetrin, në mënyrë që të zbatohet dhe të mbahet standardi më i lartë i punës, për gjyqtarët dhe prokurorët.”, u shpreh z. Metani.

I pyetur se cilat janë sfidat më të rëndësishme me të cilat përballlet zbatimi i reformës në

drejtësi, pavarësisht vlerësimit pozitiv të marrë në progres raportin e fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë tha se konsideron sfidë sensibilizimin, të kuptuarit e shoqërisë, institucioneve dhe aktorëve të tjerë mbi rëndësinë që ka sistemi i pavarur gjyqësor, duke e pranuar si të tillë edhe kur nuk na pëlqen vendimmarrja e tij.



“Nga pikëpamja kushtetuese, përcaktimi i kufijve se kur duhet të hetojmë punën e një gjyqtari/prokurori, nuk është diçka e thjeshtë, nuk është diçka e shkruar qartë, pasi siç thashë ka disa kufij virtualë, të cilët ne duhet t’i shohim, jo vetëm t’i shohim por edhe t’i respektojmë, dhe jo vetëm t’i respektojmë, por gjithashtu t’ua shpjegojmë njerëzve dhe shoqërisë. Prandaj mendoj se puna e institucioneve të drejtësisë me organizatat e shoqërisë civile është tejet e rëndësishme, për të ndihmuar njëri-tjetrin, në mënyrë që të zbatohet dhe të mbahet standardi më i lartë i punës, për gjyqtarët dhe prokurorët.”, u shpreh z. Metani.



“Sigurisht, të gjithëve u pëlqen një sistem gjyqësor i pavarur, por kjo do të thotë, që ne duhet të pajtohemi me sistemin gjyqësor, kur ai merr vendime që neve na pëlqejnë, por edhe kur merr vendime që nuk na pëlqejnë. Nëse nuk përpiqemi të krijojmë një marrëdhënie të tillë mes shoqërisë, medias, faktorëve politikë dhe institucioneve të drejtësisë, do të ketë gjithmonë një sfidë të madhe për t’u kapërcyer.

Siç thashë edhe më herët, për mendimin tim kjo është sfida më e madhe dhe ndoshta do të duhet shumë kohë për të arritur këtë standard të lartë. Nëse nuk e shohim zgjidhjen e problemeve tona të përditshme me një vizion afatgjatë dhe jemi të fokusuar vetëm në nxehtësinë e debatit të momentit, do të zgjasim agoninë dhe përpjekjet tona për arritjen e standardeve, që aspirojmë të kemi për sistemin tonë të drejtësisë.”, vërejtji z. Metani.

I pyetur mbi ekuilibrin e marrëdhënies mes

politikës e institucioneve të drejtësisë dhe mënyrat se si mund të mbrohen institucionet e drejtësisë nga politika, Inspektori i Lartë i Drejtësisë u shpreh se mbrojtja më e mirë është transparenca mbi punën që bëhet.

“Disa njerëz mund ta kritikojnë punën e sistemit të drejtësisë, disa njerëz mund të pajtohen me të, por kjo është demokracia. Është detyra jonë të jemi sa më transparentë, që të gjithë të shohin, se çfarë mendojmë ne brenda dhe të shohin se çfarë kritikojnë politikanët, bazuar në të gjithë faktorët. I vetmi instrument për të mbrojtur veten është transparenca.”



Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



Gjatë muajit Nëntor 2023, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun ka pritur 22 ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 17 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga

qytetarët, personat juridikë, grupet e interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit Nëntor 2023, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur 14 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ILD në Twitter



Inspektori i Larte i Drejtesise Artur
Metani

@ild_albania · 2 Nën

Të perceptuara shpesh si krime “pa viktime” dhe të rastësishme, krimet mjedisore shpesh renditen poshtë në listën e prioriteteve të zbatimit të ligjit. #ILD 🇲🇪 #RESIJ 🇪🇺 #COPEIJ 🌍
📌 <https://ild.al/sq/2023/11/01/mjedisi-si-ceshtje-e-autoritete...> 📷

💬 ↻ 1 ❤️ 2 Twitter



Inspektori i Larte i Drejtesise Artur
Metani

@ild_albania · 13 Nën

Happening now: Discussing about “Justice Reform in 🇲🇪 Constitutionalism in Action” with colleagues from #HJC and #IQC! Thank you for the invitation @OpenGovHub 🇺🇸
#OpenGovHub 🇲🇪 📷 4

💬 ↻ 2 ❤️ 9 Twitter



Inspektori i Larte i Drejtesise Artur
Metani

@ild_albania · 15 Nën

“Disa njerëz mund ta kritikojnë punën e sistemit të drejtësisë, disa njerëz mund të pajtohen me të, por kjo është demokracia. Është detyra jonë të jemi sa më transparentë, që të gjithë të shohin se çfarë mendojmë ne....” 📌 #ILD #KLGJ #KPK #OpenGovHub 🇺🇸

💬 ↻ 2 ❤️ 2 Twitter



Inspektori i Larte i Drejtesise Artur
Metani

@ild_albania · 20 Nën

📌 Përfunduar trajtimin e stokut të trashëguar nga institucione të tjera, krahas punës së përditshme që inspektorët kanë me trajtimin e ankesave të depozituara direkt në #ILD, procedimeve disiplinore, si dhe inspektimeve tematike e institucionale. 📌

💬 ↻ 1 ❤️ 2 Twitter

NËNTORI NË ILD ME SHIFRA

Gjatë muajit **Nëntor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **70 ankesa**, të paraqitura nga qytetarët dhe **3 ankesa** nga institucione.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Nëntor 2023**. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

VERIFIKIME

41 vendime verifikimi, nga të cilat:

- ⇒ **40 vendime verifikimi (praktika të ILD-së);**
- ⇒ **1 vendim verifikimi (dosje të mbartura nga ish KLD);**

HETIME DISIPLINORE

1 vendim për fillim hetimi disiplinor për 1 magjistratë

3 vendime për përfundim hetimi disiplinor për 3 magjistratë

ARKIVIME

125 vendime arkivimi nga 168 ankesa të shqyrtuara (80 ankesa të bashkuara), konkretisht:

- ◆ **107 vendime arkivimi pas verifikimit nga praktika të ILD, nga të cilat:**
 - ⇒ **77 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;**
 - ⇒ **30 vendime arkivimi pas verifikimit;**
- ◆ **18 vendime arkivimi nga praktika të trajtuara (dosje të mbartura nga ish KLD):**
 - ⇒ **5 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;**
 - ⇒ **13 vendime arkivimi pas verifikimit.**

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.


* mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevoje, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Nëntor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **10 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në total ka bërë ka bërë **357 shpallje publike**.





RAPORT KOMBETAR

SHQIPËRIA

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË



Bashkëpunimi për Mbrojtjen e Mjedisit nga Autoritetet Kombëtare të Inspektimit të Drejtësisë (COPEIJ)

Tetor 2023

MJEDISI SI ÇËSHTJE E AUTORITETEVE TË DREJTËSISË, ILD PËRGATIT RAPORTIN KOMBËTAR NË KUADËR TË RESIJ

Si pjesë e Rrjetit Europian të Shërbimeve të Drejtësisë (RESIJ), Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka pranuar ftesën e Rrjetit për t'u angazhuar në projektin COPEIJ, të Komisionit Evropian "Për bashkëpunimin në mbrojtjen e mjedisit përmes autoriteteve kombëtare të inspektimit të drejtësisë", përkrah institucioneve homologe të Francës, Italisë, Rumanisë dhe Portugalisë, nën menaxhimin e Expertise France.

Në këtë kuadër, anëtarë të Zyrës së ILD-së kanë marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e projektit të zhvilluara në periudhën Shkurt-Shtator 2023, që nga takimet koordinuese

tek vizitat studimore, që janë kryer me rotacion në secilin nga vendet e projektit, e gjatë të cilave autoritetet kombëtare vendase, përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit kanë referuar praktikat e punës dhe sfidat si institucionale ashtu edhe ligjore.

Në përfundim të kësaj faze, secili vend përgatit një Raport pune, në gjuhën frënge, me panoramën dhe rekomandimet për autoritetet kombëtare dhe Komisionin Evropian, për krijimin e mjeteve për reduktimin e hendekut mes nevojës për drejtësi penale efektive mjedisore dhe realitetit aktual në secilin vend.

Ekipi i zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përgatiti raportin kombëtar mbi vendin tonë, që përmban kuadrin juridik kombëtar e ndërkombëtar, kuadrin institucional, jurisprudencën vendase dhe të GJEDNJ mbi krimin mjedisor, paraqitjen e autoriteteve administrative shqiptare, ato gjyqësore të specializuara dhe autoritete të tjera civile, të dhëna statistikore, bashkëpunime dhe praktika pune si dhe rekomandime për autoritetet kombëtare dhe për Komisionin European, si porositi i projektit.


Ekipi i zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përgatiti raportin kombëtar mbi vendin tonë, që përmban kuadrin juridik kombëtar e ndërkombëtar, kuadrin institucional, jurisprudencën vendase dhe të GJEDNJ mbi krimin mjedisor, paraqitjen e autoriteteve administrative shqiptare, ato gjyqësore të specializuara dhe autoritete të tjera civile, të dhëna statistikore, bashkëpunime dhe praktika pune si dhe rekomandime për autoritetet kombëtare dhe për Komisionin European, si porositi i projektit.

“Të perceptuara shpesh si krime “pa viktime” dhe të rastësishme, krimet mjedisore shpesh renditen poshtë në listën e prioriteteve të zbatimit të ligjit dhe zakonisht ndëshkohen me sanksione të ulëta, si rezultat i përkufizimeve të paqarta dhe keqinterpretimit të koncepteve.

Në këtë kontekst, ky raport bazë mundëson një analizë të detajuar të kuadrit ligjor mjedisor shqiptar, të kapaciteteve institucionale, duke përfshirë si aspektin e burimeve njerëzore dhe financiare, ashtu edhe aspekte të veprimtarisë së tyre.”

”, thuhet në raportin

Raportin e plotë e gjeni në linkun : <https://ild.al/wp-content/uploads/2023/11/COPEIJ-RAPORTI-shqip.pdf>





FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË KONFERENCËN “KOHËZGJATJA GJYQËSORE NË APEL 2016-2023 DHE AFATET E GJYKIMIT TË ARSYESHËM”

I nderuar z. Ambasador Vos,
E nderuar Znj. Llagami!
I nderuar z. Shella,
Të nderuar të ftuar,
Përshëndetje të gjithëve!

Dua ta filloj me një falenderim për zotin Shella dhe qendrën Infocip për ftesën dhe organizimin e këtij aktiviteti dhe mbi të gjitha për hartimin e këtij raporti.

Personalisht, e vlerësoj shumë angazhimin e vazhdueshëm të Qendrës tuaj, në lidhje me monitorimin e veprimtarisë së gjykatave, me fokus të veçantë kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore apo zhvillimin e gjykimeve brenda fateve të arsyeshme, duke dale edhe me një produkt real, me sugjerime konkrete dhe profesionale për këto çështje.

E shoh shumë të rëndësishëm rolin tuaj si shoqëri civile, pasi organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm në forcimin e pro-

ceseve demokratike, konsolidimin e qeverisjes së mirë, respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies. Kjo sipas mendimit tim, duhet bërë jo vetëm me procese monitoruese, jo vetëm nëpërmjet presionit pozitiv ndaj vendim-marrësve dhe drejtuesve të organeve të reja të drejtësisë, jo vetëm me mbikëqyrjen e veprimtarisë dhe kërkimin e përgjegjësive nga këto organe, por roli juaj duhet të shkojë përtej kësaj, me paraqitjen e mënyrave alternative të mbrojtjes së interesave të qytetarëve, me analizat dhe propozime konkrete për adresimin e çështjeve të drejtësisë, me kontribut real në zhvillimin e reformës së drejtësisë në Shqipëri. Kjo pasi unë mendoj se reforma në drejtësi, por dhe në përgjithësi drejtësia si vlerë shoqërore nuk mund të jetë betejë, vetëm e institucioneve të drejtësisë.

Padyshim që ato kane rolin dhe përgjegjësinë me të madhe. Por standardet e drejtësisë, të shtetit dhe të sensit të së drejtës duhen kul-

Efiçenca e sistemit gjyqësor është një çështje delikate dhe e rëndësishme, jo vetëm në planin kombëtar, por edhe në rrugën drejt integritimit në BE.

Progresi i reformës në gjyqësor është i lidhur ngushtësisht me progresin e Shqipërisë drejt integritimit në Bashkimin Evropian, si një nga prioritetet kyçe të vendit. Shqipëria është në një fazë të rëndësishme të procesit të integritimit në BE, ku përfshirja e të gjithë aktorëve është thelbësore. Pushteti gjyqësor dhe reformimi i tij është një nga sfidat më të mëdha që ka Shqipëria.

tivuar nga të gjithë ne, institucionet e drejtësisë, politika, media e shoqëria civile.

Në këtë kuadër e shoh dhe e vlerësoj edhe raportin e përgatitur dhe të paraqitur në këtë tryezë.

Nga ana tjetër efiçenca e sistemit gjyqësor është një çështje delikate dhe e rëndësishme, jo vetëm në planin kombëtar, por edhe në rrugën drejt integritimit në BE. Progresi i reformës në gjyqësor është i lidhur ngushtësisht me progresin e Shqipërisë drejt integritimit në Bashkimin Evropian, si një nga prioritetet kyçe të vendit. Shqipëria është në një fazë të rëndësishme të procesit të

integritimit në BE, ku përfshirja e të gjithë aktorëve është thelbësore. Pushteti gjyqësor dhe reformimi i tij është një nga sfidat më të mëdha që ka Shqipëria. Në këtë kuadër gjej rastin të falenderoj edhe Ambasadën Hollandeze për mbështetjen që po i jep këtij procesi.

Faleminderit Ambasador Vos!

Në Shqipëri aktualisht është duke u zbatuar reforma në drejtësi. Kjo reformë ka për qëllim ngritjen e një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit të hapur, të përgjegjshëm dhe efiçent, i cili të gëzojë besimin e publikut. Procesi





i jetësimit praktik të reformës, ka qenë dhe mbetet një sfidë thelbësore.

Masat të cilat janë marrë dhe po ndërmerren në kuadër të gjykimit brenda afateve të arsyeshme, nuk duhet të jenë vetëm në kuadër të procesit legjislativ, por nevojiten masa dhe mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht. Ne kemi detyrimin që të organizojmë sistemin ligjor për të garantuar respektim të kushteve të

parashikuara në nenin 6§1 të KEDNJ-së, si dhe të aplikojmë një sërë masash efektive, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një afati të arsyeshëm.

Disa metoda në aspektin administrativ mund të zbatohen nga vetë gjykatat, për të nxitur përkohësisht përsheptimin e gjykimit të çështjeve. Një tjetër mekanizëm për rritjen e efikasitetit mund të jetë edhe sistemi i vlerësimit të magistratëve, i cili mund t'i nxisë në mënyrë

Ngarkesa në punë që shoqëron sot magistratët, që lidhet edhe me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, është një kriter objektiv, që mbahet parasysh për zhvillimin e proceseve gjyqësore dhe kohën e nevojshme për të arsyetuar vendimet gjyqësore të dhëna, ndaj dhe bazuar në këtë kriter objektiv, koha që i është dashur magistratëve për të arsyetuar vendimet gjyqësore, i shërben jo vetëm rritjes së cilësisë në aspektin përmbajtësor të vendimit gjyqësor të dhënë në drejtim të palëve ndërgjyqëse, të cilave u drejtohet ky vendim, por edhe forcimit të besimit të publikut për një gjykim të drejtë, ku thelbi i këtij parimi është një vendim gjyqësor i mirëarsyetuar.



të vazhdueshme të rrisin performancën, apo rritja e kapaciteteve njerëzore dhe financiare. Megjithatë, vlen të theksohet se mjeti i fundit dhe i jashtëzakonshëm, i cili duhet të aplikohet është procedimi disiplinor i magistratëve, në lidhje me zhvillimin e proceseve gjyqësore të tejzgjatura.

Në rastin konkret, rezulton prima facie, se pavarësisht afateve të parashikuara në ligjin procedural, këto afate jo gjithmonë janë zbatuar me rigorozitet nga ana e magistratëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Në këtë rast, mosrespektimi i afateve procedurale nga ana e magistratëve nuk duhet të konsiderohet apriori, si një shkelje e mundshme disiplinore. Për të arritur në konkluzionin nëse nga ana e magistratëve janë ndërmarrë veprime/mosveprime, të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e tyre profesionale, duhet të analizohen rast pas rasti nëpërmjet një procesi verifikimi apo hetimi disiplinor një sërë çështjesh, të cilat kanë të bëjnë me identifikimin e elementeve

faktikë dhe juridikë mbi përgjegjësinë disiplinore të magistratëve.

Ngarkesa në punë që shoqëron sot magistratët, që lidhet edhe me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, është një kriter objektiv, që mbahet parasysh për zhvillimin e proceseve gjyqësore dhe kohën e nevojshme për të arsyetuar vendimet gjyqësore të dhëna, ndaj dhe bazuar në këtë kriter objektiv, koha që i është dashur magistratëve për të arsyetuar vendimet gjyqësore, i shërben jo vetëm rritjes së cilësisë në aspektin përmbajtësor të vendimit gjyqësor të dhënë në drejtim të palëve ndërgjyqëse, të cilave u drejtohet ky vendim, por edhe forcimit të besimit të publikut për një gjykim të drejtë, ku thelbi i këtij parimi është një vendim gjyqësor i mirëarsyetuar.

Jo në çdo rast mosrespektimi i afateve të përcaktuara nga ana e legjislacionit procedural dhe në mënyrë të veçantë afatet e parashikuara për të dorëzuar brenda një afati të arsyeshëm vendimet e arsyetuara do të konsiderohen si shkelje të mundshme disiplinore.



Që këto shkelje të konsiderohen si të tilla, duhet të ketë një mungesë kujdesi dhe operativiteti, aftësie profesionale apo neglizhencë, të tilla që kalojnë “kufirin e të arsyeshmes”, dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet nga ana e magistratit.

Vonesa në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve përbën shkelje disiplinore, kur përbën rast përsëritës, të rëndë, dhe të pajustificuar, si dhe në të njëjtën kohë, nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë situatë, që është jashtë kontrollit të magistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor.

Ky ka qenë edhe qëndrimi institucional, që ka mbajtur Inspektori i Lartë i Drejtësisë në inspektimin tematik, të kryer disa muaj më parë në Tiranë, në dy gjykata të rëndësishme. Dhe me këtë arsye, inspektimi tematik ka rezultuar edhe me disa afate konkrete për zbardhjen e vendimeve gjyqësore, si dhe me verifikime apo hetime për magistratë të caktuar, në këto dy

gjykata. Vlen të theksohet se ky inspektim ishte një fotografim i periudhës, në të cilën u krye inspektimi dhe nuk mund të jetë i zbatueshëm në gjykata të tjera të vendit, apo në periudha të tjera kohore.

Gjërat ndryshojnë në gjykata të ndryshme të vendit dhe mund të ketë dinamika në periudha të ndryshme kohore. Por e rëndësishme është të theksohet, se Inspektori i Lartë i Drejtësisë, u ka treguar magistratëve një metodologji, në të cilën do bazohet verifikimi i punës së tyre, për çështjet që kanë të bëjnë me zbardhjen e vendimeve gjyqësore.

Këto mendime gjykova të ndaj me ju në këtë takim. Shpresoj që ky lloj aktivizmi të vazhdojë edhe nga ju z. Shella, por edhe nga organizata të tjera, për çështje, që i takojnë drejtësisë dhe punës së organeve të saj.

Ju faleminderit!

NËNTOR 2023

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD


**KONTAKT ILD**

WEB: ild.al
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
 Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
 Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

*Kliko për të ndjekur spotin
 prezantues të ILD*



Më skano!